



In medias res

Etapat e reformës kurrikulare dhe të hartimit të kurrikulave

*“75 % e risive nuk mund të mbahen në konceptin e tyre fillestar”
Markee, 1997*

Koncepti kurrikul është i ri në gjuhën shqipe. Ai dallon nga koncepti plan dhe program, sepse derisa me planin dhe programin ishin të parapara përmbajtjet mësimore që duhet mësuar dhe koha e nevojshme për mësimin këtyre përmbajtjeve, kurrikuli është një dokument me të cilin **parashihet jo vetëm çka do të mësohet, por edhe si do të mësohet**. Megjithatë përkufizimi i konceptit të kurrikulit është i vështirë. Kjo ka bërë që sot ekzistojnë mbi 50 përkufizime të këtij dokumenti. Sipas disave kurrikuli është një **“kontejner”** ku mund të futet çdo gjë që lidhet me edukimin dhe arsimin. Në Enciklopedinë ndërkombëtare të arsimit, kurrikuli përcaktohet si: *“plan për një ligjërime dhe të nxënësve të qëndrueshëm”*. Ralf Tejlor dhe H.Taba *“kurrikulin e definojnë si një plan për veprim ose një dokument i shkruar që përfshinë strategji për arritjen e objektivave ose të qëllimeve të dëshiruara”*

Unë, me kurrikul nënkuptojë një kontratë të shtetit- institucionit me qytetarët/nxënësit dhe studentët e vetë që garanton aftësimin e tyre për të nxënë gjatë gjithë jetës si dhe përgatitjen e tyre për t'u përballë me sfidat jetësore dhe për të marrë pjesë aktive në tregun botëror të punës.

Kurrikuli është një meny ushqimi që mundëson zhvillimin maksimal fizik, shëndetësor, mendor, emocional dhe social të secilit nxënës/student. Kurrikuli gjithnjë duhet të bazohet në filozofinë e caktuar të shkollës apo të një vendi, sepse përndryshe nuk është i zbatueshëm.

Në teori dhe praktikë ekzistojnë lloje të ndryshme: **kurrikuli i dukshëm** (*apparent curriculum*) që paraqet atë që parashikohet të zhvillohet, **kurrikuli i fshehtë** (*hidden curriculum*) kurrikuli i paobliguar dhe i pa planifikuar; **kurrikuli i pashkruar** (*unwritten curriculum*) tërë ajo që mësohet në shkollë; **kurrikuli formal** (*real curriculum*); **kurrikuli kombëtar** (*common or basic or nacional curriculum*) i detyruar për të gjithë nxënësit e nivelit të caktuar në nivel vendi; **skelet kurrikuli** (*core curriculum*) i përbërë nga disa lëndë të obliguara; **kurrikuli shkollor** (*school curricula*)

Për të bërë reformën kurrikulare duhet qartësuar këto nocione, sepse me qartësimin tyre bëhet përcaktimi edhe për llojin e kurrikulave që do të reformohen apo përfshihen me reformë kurrikulare.

Reforma kurrikulare kalon nëpër katër faza/etapa: **etapa e aktiviteteve përgatitore apo preparative; etapa e hartimit të kurrikulit; etapa e zbatimit të kurrikulit dhe etapa e evaluimit – vlerësimit të kurrikulit.**

Në teori ekzistojnë mendime të ndryshme për etapa reformës kurrikulare. Në të vërtetë janë dy teori që merren me etapat e reformës kurrikulare: **teoria tekniko–shkencore** me përfaqësuesit: Bobit, Tejlor, Taba, Hunkins etj. dhe teoria jo teknike – joshkencore.

Deri sa në teorinë e parë kurrikuli është mënyrë e të menduar për të arritur maksimumin në të nxënësve / studentëve, teoria joteknike – joshkencore thuhet se qëllimet përfundimtare të arsimit nuk mund të dihen, madje thonë, as që është e nevojshme të dihen në çdo rast, andaj mendojnë se kurrikuli më shumë evoluon se sa planifikohet me përpikëri. Ekziston edhe një qëndrim i mesëm të cilin e përfaqësojnë: Glatthor, Senge, Dillon etj. Të cilët e quajnë veten postmodernist. Këtu qendra është nxënësi.

Elaborimi i secilës etapë do të vazhdon në numrin ardhshëm

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Më 2-3 shtator 2010 është mbajtur trajnimi për trajnerë për programin "Hartimi i projekt propozimeve me metodën e kornizës logjike". Pjesëmarrës në trajnim ishin BPT-të si dhe drejtorë e mesimdhënës, të cilët do të aktivizohen për mbajtjen e trajnimeve për shkollat përfituese. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësve u janë shpërndarë materialet e trajnimit dhe veglat e nevojshme për trajnerë.

■ Gjatë muajit shtator janë themeluar mbi 11 ekipe komunale të granteve shkollore. Këto ekipe janë të domosdoshme për të bërë listimin e shkollave të komunës së tyre në bazë të kriterëve dhe indikatorëve të aprovuar nga këshilli për aprovimin e granteve shkollore. Ky këshill do të bëjë përzgjedhjen e 151 shkollave që do të përfitojnë në kuadër të këtij programi.

■ Më 24 shtator 2010 është mbajtur një konferencë gjysmë ditore për fillimin e programit të granteve për zhvillimin e shkollave. Në këtë konferencë u prezantua qëllimi i programit, objektivat e tij, mënyra e përzgjedhjes së shkollave dhe formula e cila do të përdoret me rastin e ndarjes së granteve për shkollat.



Në konferencë morrën pjesë mbi 100 veta, përfaqësues të MASHT, DKA, Zyrave rajonale të inspeksionit, si dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare që kontribuojnë në sferën e arsimit.

KOSOVISION Contest

■ Në kuadër të këtij projekti janë realizuar aktivitetet e para sipas planifikimit. Fillimisht janë mbajtur takimet me Drejtorët e shkollave të cilët janë informuar për projektin e KOSOVISION CONTEST dhe prej të cilëve është kërkuar një përkrahje më e madhe për mesimdhënësit. Takimet me drejtorë kanë qenë të frytshme dhe projekti është konsideruar si shumë i frytshëm për mesimdhënësit dhe nxënësit e klasave të pesta.



■ Pas takimeve me drejtorë, janë organizuar edhe 60 punëtori në të gjitha Komunitat me mesimdhënësit e klasave të pesta të cilët janë trajnuar për mënyrën e punës në këtë projekt dhe janë pajisur me materialet e duhura për punë të mëtutjeshme.

■ Që nga data 20 shtator, klasat e pesta kanë filluar edhe punën e tyre në këtë projekt. Kanë filluar të mbahen punëtoritë me nxënësit dhe të gjithë janë të

entuziazmuar për punën që i pret në të ardhmen.



Vizitat bëhen të vazhdueshme për monitorimin e punëtorive në klasat e pesta, qoftë nga stafi i KOSOVISION CONTEST e po ashtu edhe nga vet Menaxherët e projektit.



Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji është organizuar diskutimi publik i raportit të parë të dalë, në kuadër të këtij projekti. Raporti është punuar dhe është përkthyer edhe në gjuhën angleze dhe serbe. Të ftuar në këtë prezantim publik kanë qenë përfaqësues të ndryshëm nga MASHT, ECLO,

Drejtorë shkollash, monitorë të jashtëm e të brendshëm të cilët punojnë në kuadër të këtij projekti e po ashtu edhe nxënës të Komiteteve të ndryshme.



Prezantimi i raportit u bë nga Z. Dukagjin Pupovci, Drejtori Ekzekutiv në Qendrën për Arsim të Kosovës. raporti do të botohet dhe do të jetë në dispozicion të të gjithë të interesuarve.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

- Në kuadër të këtij projekti gjatë muajit shtator janë organizuar këto aktivitete:
 - Më 07 shtator 2010 u mbajt një takim virtual i projektit ku morën pjesë koordinatorët e projektit nga organizatat partnere. U diskutuan në detaje aktivitetet e projektit dhe organizimi i punëtorisë për hartimin e strategjisë për bashkëpunimin në mes të organizatave partnere në projekt.
 - U finalizua sinteza e raporteve kombëtare dhe gjendet ne ueb faqen e projektit www.apreme.net
 - U finalizua edhe materiali për publikimin e librit me praktikat më të mira të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grupeve pakicë në jetën e shkollës nga shtetet partnere.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë kësaj periudhe është organizuar një punëtori njëditore me autorët e teksteve shkollore dhe përfaqësuesit e shtëpive botuese. Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të komponentës së dytë të projektit që është Zhvillimi i kurrikulumit.

■ Gjatë muajit shtator janë bërë përgatitjet për punëtoritë / konferencat që do të mbahet në fillim të muajit tetor. Këto punëtori do të mbahen me grupet punuese që do të punojnë në hartimin e kurrikulumit të Kosovës.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Objektivi i përgjithshëm i projektit të financuar nga BE “Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet RAE” është të përkrahet Qeveria e Kosovës në zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe multi-etnike duke e zbatuar Strategjinë për komunitetet RAE dhe Planin e Veprimit për këtë.

Si objektive konkrete e Projektit është përmirësimi i mirëqenies socio-ekonomike të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë duke iu lehtësuar qasjen në shkollim dhe njëkohësisht duke e ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore të komuniteteve RAE si dhe përmirësimin e informacionit për/mbi RAE në mediat kryesore.

Projekti ka dy komponentë kryesor:

- Arsimin
- Mediave/Kulturës

■ Komponenti i Arsimit – Projekti do të themelon 6 Qendra Mësimore në 5 komuna, që do ta lehtësojnë pjesëmarrjen e rreth 1.100 fëmijëve të komuniteteve RAE në katër programe mësimore që kanë në qendër fëmijën: përgatitja për parashkollor, ndihmë në detyrat e shtëpisë, pako ndihmëse që përmbajnë materiale shkollore dhe aktivitete rinore. Kjo do t'i përgatis nxënësit të hyjnë në shkollë dhe në mënyrë të suksesshme të mbesin aty dhe të vijojnë rregullisht mësimin. Do të formohen grupe të vogla të cilat do të përqendrohen tek interesat e fëmijut, do të përmirësohet shkrim-leximi, numërimi, gjuha dhe aftësitë shoqërore, fitimi i vetëbesimit dhe kënaqësia gjatë procesit mësimor. Paraqitja e sistemit me tutorë do t'i ndihmojë komunitetet të ndërtojnë kapacitetet e tyre dhe t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në arritjen e rezultateve më të mira mësimore. Gjithashtu, do të ofrohen kurse shkrim-leximi për gratë RAE.

Njëkohësisht do të organizohen programe përgatitore për pranim në shkollim sekondar dhe terciar. Do të krijohet një skemë e bursave që ka për qëllim mbështetjen e pjesëmarrjes në shkollim sekondar e terciar.

■ Projekti implementohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) në partneritet me 8 OJQ vendore, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e Kosovës si dhe me komunat përfituese. Periudha e implementimit dhe

kohëzgjatja e projektit është prej 1 Shtator 2010 deri më 31 Gusht 2012.

Bazuar në marrëveshjen e bërë ndërmjet KFOS dhe KEC, kjo e fundit është përgjegjëse për koordinimin dhe implementimin e aktiviteteve që lidhjen me Komponentin 1 (Arsimin) të Projektit.

■ Gjatë këtij muaji janë vizituar 6 qendrat e komunitetit si dhe një varg vizitash tjera në terren.

Gjithashtu ka pasur takime me organizatat partnere dhe me palët e tjera të përfshira.

Përgatiti: Petrit Tahiri